

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BOTIME, PRINTIME DHE MATERIAL SHTYPSHKRIMI”, PËR SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 22900000-09.

VLERA E FONDIT LIMIT: 4,639,313 (katër milion e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e treqind e trembëdhjetë) **Lekë (pa TVSH).**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të L.PP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2019, 2020, 2021) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimet e lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e shërbimeve të realizuara.
 - Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e hapur e thjeshtuar të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Operatori ekonomik për të vertetuar që ka kapacitetet teknike për të ekzekutuar kontratën duhet të disponojë pajisjet e mëposhtme:
 - Minimumi një makinë shtypi me format min 50 cm x 70 cm;
 - Minimumi një makinë qepëse;
 - Minimumi një makinë telefoni;

Operatori ekonomik për të vertetuar se i disponon këto tre pajisje duhet të paraqesë dokumentacionin në një nga formatet e mëposhtme:

- Kontrata shitblerje/ Fatura shitblerje, ose
- Kontrata huapërdorje, ose
- Kontrata qiramarrje, ose
- Kontrata e dhurimit;
- Çdo dokument sipas legjislacionit në fuqi;

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT.

3. Operatori/et ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt i prokurimit, duhet të ketë minimalisht të punësuar 2 punonjës.
 - Për punonjësit e kërkuar të paraqitet kontrata pune përkatëse.

Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtem:

Nr	Emri Mbiemër	Profesioni	Data e fillimit të marrëdhënieve të punës

Shënim: Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afatit të ankimit ofertuesi fitues që të dorëzojë kontratat individuale të punës pranë AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e transportit të shërbimit, për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë **të paktën 1 (një) automjet transporti**, me qëllim transportin e mallrave, të cilët duhet t’i ketë në pronësi ose me qira.

Për sa me sipër operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë përkatëse sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtës	Statusi
1				Pronësi/qira/përdorim

Shënim: Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afatit të ankimit ofertuesi fitues që të dorëzojë dokumentacionin për mjetin e mësipërm, që vërtetojnë pronësinë, qiranën, ose huapërdorjen, (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje si dhe çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë) si dhe lejen e qarkullimit të mjetit.

Mjetet që do të deklarohen, detyrimisht do të paraqiten Autoritetit Kontraktor për të gënjë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

5. Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate ku merr persiper shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi në ambjentet e magazinimit pranë ambjenteve të Spitalit Universitar të Traumës.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratat të rreme, të praqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuese, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do te ndiqet procedura per perjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Data e publikimit të njoftimit është 01.12.2022 dhe data e zhvillimit të procedurës së prokurimit elektronik është **12.12.2022 ora: 12:00** në faqen e internetit www.app.gov.al, në Ministrinë e Brendshme, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Njësia e prokurimit:
Znj. Lorena BARJAMAJ
Znj. Misona SHPUZA
Znj. Viola TRESKA